



**Republika e Kosovës**  
**Republika Kosova - Republic of Kosovo**

**AGJENCIA KUNDËR KORRUPSIONIT**  
**AGENCIJA PROTIV KORUPCIJE**  
**ANTI - CORRUPTION AGENCY**

DATE/A:	20.08.2014
REFERENC-Ë:	AKK- DPK- DPKPP
PËR/ZA/TO:	z. Astrit SHYTI Zyrtar i Prokurimit në NP. Termokos sh.a.
CC:	z. Arsim JANOVA Kryeshef Ekzekutiv i NP. Termokos sh.a.
NGA/OD/FROM:	z. Hasan PRETENI Drejtor i Agjencisë Kundër Korrupsionit
TEMA/SUBJEKAT/SUBJECT:	Opinion lidhur me Tenderin me titull " Furnizim me Mazut "

**I nderuari z. Shyti ,**

Në mbështetje të nenit 5 paragrafi 1 nën paragrafi 1.12 të Ligjit nr. 03/L-159 për Agjencinë kundër Korrupsionit dhe nenit 19 paragrafi 1 nën paragrafi 1.6 të Ligjit nr. 04/L-051 për Parandalimin e Konfliktit të Interesit në Ushtrimin e Funkcionit Publik, lidhur me Tenderin " Furnizim me Mazut " me numër prokurimi: TER-14-026-111, Agjencia kundër Korrupsionit, ofron këtë:

**OPINION**

Me të cilin kërkohet nga ju si Autoritet Kontraktues që t'i ndërmerri të gjitha veprimet e nevojshme për evitimin e shkeljeve të evidentuara në lidhje me Tenderin " Furnizim me Mazut " me numër prokurimi: TER-14-026-111 (ri-tender), në mënyrë që të respektohen dispozitat përkatëse të Ligjit nr. 04-L/042 për Prokurimin Publik.

## A r s y e t i m

Zyra e Prokurimit në Ndërmarrjen Publike Termokos Sh.a. ka përgatitë njoftimin për kontratë me titull "Furnizim me Mazut" me numër prokurimi: TER-14-026-111 (ri-tender), i cili është publikuar në faqen elektronike të KRPP-së me dt.30.07.2014 në Procedurë të Hapur. Divizioni për Parandalimin e Korrupsionit në fushën e Prokurimit Publik (DPKPP) pranë, Agjencisë kundër Korrupsionit, sipas detyrës zyrtare ka identifikuar dhe trajtuar këtë procedurë të prokurimit. Gjatë shqyrtimit dhe ekzaminimit të dokumenteve të dosjes së këtij tenderi, AKK ka hasur në disa kritere të cilat nuk janë në pajtim me Legjislacionin në fuqi i cili e rregullon fushën e Prokurimit Publik në Republikën e Kosovës.

Agjencia kundër Korrupsionit pasi ka shqyrtuar me kujdes dokumentacionin e ofruar nga ana e Autoritetit kontraktues ka konstatuar të faktet si në vijim:

Në njoftimin e publikuar për kontratë dhe në dokumentet e dosjes së tenderit tek rubrika III.2.3 Kapaciteti ekonomik dhe financiar pika 1 dhe 2, autoriteti kontraktues ka kërkuar **raport mbi qarkullimin bankar mbi 10,000,000.00 Euro ( për furnizime me derivate të naftës/mazutit ), si dhe raportin e auditimit mbi kompaninë, në dy vitet e fundit (2012,2013)** kërkesa këto për të cilat konsiderojmë se bien ndesh me Ligjin e Prokurimit Publik. Sipas LPP-së një Autoritet kontraktues ka të drejtë që në kuadër të kritereve të përzgjedhjes të kërkojë, dëshmi nga Operatorët ekonomik me të cilat do ta vërtetonte aftësinë e tyre ekonomike - financiare, por nuk është e lejuar që si qarkullim financiar të kërkojë shumën e cila e kalon dyfishin e vlerës së parashikuar të kontratës. Autoriteti kontraktues po ashtu nuk ka të drejtë që përmes raporteve bankare t'a vërtetojë aftësinë teknike dhe profesionale të Operatorëve ekonomik. Furnizimet e tilla me derivate të naftës dhe mazutit mund të vërtetohen përmes kontratave dhe referencave për furnizimet e ngjashme në 3 vitet e fundit, nuk është e lejuar që dëshmitë për furnizimet e tilla të kërkojnë përmes raporteve bankare.

Lidhur me pikën 2 ku Autoriteti kontraktues ka kërkuar raportin e auditimit mbi kompaninë, në dy vitet e fundit dhe kopjet e raportit të verifikuar nga një auditor i licencuar ose firmë auditimi/revizioni.

Sipas LPP-së nëse një Autoritet kontraktues e vendos një kërkesë të tillë, atëherë kërkesat e tilla do t'i referohen maksimum 3 viteve të fundit financiare të përfunduara nga data e publikimit të njoftimit të kontratës. Vitet e tilla financiare do të tregohen shprehimisht në njoftimin për kontratë dhe dosjen e tenderit. Autoriteti kontraktues nuk ka të drejtë të kërkojë raporte të auditimit vetëm në 2 vitet e fundit pa i kërkuar të njëjtat në 3 vitet e fundit. Autoriteti kontraktues duhet të ketë kujdes që në rast se kërkon raporte të auditimit për Operatorët ekonomik të njëjtat ti kërkojë nga një kompani e auditimit me reputacion e jo të pranojë raporte të auditimit vetëm nga auditori edhe nëse ai është i licencuar

**Duke kërkuar qarkullim bankar mbi 10,000,000.00 Euro si dhe duke i kërkuar raportet e auditimit mbi kompaninë vetëm në dy vitet e fundit (2012,2013), Autoriteti kontraktues e kufizon apo e zvogëlon konkurrencën në mesin e operatorëve ekonomik, prandaj veprimet e Autoritetit kontraktues në këtë mënyrë konsiderohen edhe shkelje e nenit 7 të LPP-së.**



Agjencia kundër Korrupsionit gjithashtu ka vërejtur se tek rubrika III.2.4) Kapaciteti teknik dhe profesional pika 1. ku është kërkuar përshkrimi i pajisjeve për transport. Autoriteti kontraktues ka kërkuar që *çdo ofertues duhet të dëshmojë se ka se paku dhjetë (10) auto cisterna mbi 20.00 ton, ( ose kapacitet transporti mbi 200,ton )* kërkesë kjo për të cilën gjithashtu konsiderojmë se është kërkesë diskriminuese dhe mund të kufizoj apo eliminoj konkurrencën e lirë. Agjencia kundër Korrupsionit rekomandon që të veprohet në mënyrë të drejtë gjatë tërë procedurave të prokurimit pa imponuar obligime të panevojshme ose pengesa për Operatorët ekonomik të cilët mund ti bëjnë furnizimet përkatëse. Pra, të shmanget çdo trajtim që favorizon një furnizues dhe i diskriminon Operatorët tjerë ekonomik.

Veprimet e Autoritetit Kontraktues konsiderojmë se bien ndesh me nenin 7 Barazia në Trajtim/Jo-Diskriminimi, nenin 68 Gjendja Ekonomike dhe Financiare, nenin 69 Aftësia Teknike dhe Profesionale të Ligjit për Prokurimin Publik Nr.04/L-042, nenin 23 Kriteret e përzgjedhjes e Udhëzuesit Operativ për Prokurimin Publik dhe nenin 5 Gjendja ekonomike dhe Financiare e Udhëzimit administrativ Nr.02/2014 të KRPP-së.

Konsiderojmë se shkelje të tilla, nuk duhet lejuar në procedura të prokurimit, andaj Agjencia kundër Korrupsionit rekomandon anulimin e kësaj procedure të prokurimit dhe kërkon nga Autoriteti Kontraktues që t'i shmang praktikat e tilla në të ardhmen.

Autoritetet Kontraktuese e informojnë Agjencinë për veprimet e ndërmarra.

Me respekt !